

Data: 30/03/2026

**PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS - MALL
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: Blerje karburant.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Karburant diesel -09134100-8

VLERA E FONDIT LIMIT: 27,297,067 (Njëzet e shtatë milionë e dyqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëdhjetë e shtatë) Lekë pa TVSH ose 284,314(Dyqind e tetëdhjetë e katër mijë e gjashtëdhjetë e shtatë) Euro pa TVSH.

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 30/03/2026 është 96.01 Lekë/Euro.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT.

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, **sipas Shtojcës 9;**

b. Sigurimin e Ofertës, sipas **Shtojcës 4;**

Argumentimi:

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82, “Formulari përmbledhës i vetdeklarimet” dhe Nenit 83 “Sigurimi i ofertës” të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar.

Në Nenin 83 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar citohet: “*Autoriteti Kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël*”, Në Nenin 82, të LPP, i ndryshuar “1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet Kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimet, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik*”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: Bazuar sa më sipër

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, i ndryshuar, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, i ndryshuar, si dhe nenin 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në dispozitat e legjislacionit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. VKM-së nr.922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”.

Vlera e xhiros së përcaktuar dhe të kërkuar nga autoriteti kontraktor kërkohet për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike të operatorit ekonomik si dhe për të vendosur kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 39% e fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi:

Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të

ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **vërtetim të lëshuar nga ISHTI**, që subjekti ofertues ka importuar ose tregtuar karburante sipas standardeve të legjislacionit shqiptar dhe nuk ka pasur penalitete për shkelje të cilësisë për **vitin 2025**.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 7/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se e ushtrojnë aktivitetin e tyre në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës.

Ky kriter është vendosur për të siguruar AK që OE ka importuar ose tregtuar karburante sipas standardeve të Legjislacionit Shqiptar, dhe nuk ka patur penalitete për shkelje të cilësisë. Nëpërmjet këtij kriteri autoriteti kontraktor kërkon të krijojë sigurinë, besueshmërinë dhe garancinë për cilësinë e mallit që do të prokurojë.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **fletë analiza të lëshuara nga ISHTI**, të cilat duhet jenë **të lëshuara brenda 3 (tre) muajve nga data e hapjes së ofertave**.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 4, e LPP, i ndryshuar, si dhe nenin 40, pika 6/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Referuar ligjit nr.8450 datë 24.02.1999 “Për Përpunimin, Transportimin dhe Tregëtimin e Naftës, të Gazit dhe nën produkteve të tyre”, i ndryshuar, Shoqëritë e tregtimit me shumicë të naftës dhe nën produkteve të saj, ashtu edhe stacionet e shitjes së karburanteve, i nënshtohen kontrollit periodik të standardeve teknike të naftës dhe nën produkteve të saj, e rrjedhimisht OE kane detyrimin që të paraqesin Fletë analizat të lëshuar nga ISHTI për produktet që do të ofrojnë.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **listën e stacioneve të tregtimit me pakicë të karburanteve**, sipas adresave të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor, si më poshtë:

- **Bashkia Tiranë – minimumi 4 (katër) pika karburanti**

Në akset kryesore rrugore të territorit të Republikës së Shqipërisë:

- Tiranë – Lezhë – Shkodër
- Tiranë – Durrës – Fier – Vlorë
- Tiranë – Kukës – Tropojë

Këto stacione të jenë të vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontrate qiraje ose akt pronësie ose të jenë të pasqyruara në ekstraktin e regjistrimit tregtar lëshuar nga QKB). Stacionet e tregtimit me pakicë të karburanteve të cituara me lartë detyrimisht duhen të jenë të pajisur:

- Licencë për tregtim karburanti me pakicë të lëshuar nga pushteti vendor.
- Leje mjedisore përkatëse të lëshuar nga QKL.
- Vërtetim teknik nga **Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK)**.
- Certifikatë të mbrojtjes nga zjarri nga **MZSH**.
- Policë sigurimi të vlefshme për distributorët e shitjes me pakicë.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 4, e LPP, i ndryshuar, si dhe nenin 40, pika 5, germa "a" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" si dhe ligjit Nr.8450 datë 24.02.1999 "Për Përpunimin, Transportimin dhe Tregëtimin e Naftës, të Gazit dhe nën produkteve të tyre", i ndryshuar, nenin 20 "Autorizimet", dhe Kreu për dhenien e licencave për tregtim me pakice.

Njësia e Prokurimit, për mos ta kufizuar këtë kriter ka qykuar dhe ka kërkuar si alternativë një nga format e disponimit sipas Kodit Civil për këto stacione, ku vec kontratës së qirasë ose aktit të pronësisë ka kërkuar që të jenë të pasqyruara në ekstraktin e regjistrimit tregtar lëshuar nga QKB. Gjykojmë se një nga format e mësipërme, garanton marrjen e një produkti me cilësi dhe u arsyetuan të nevojshme për të siguruar ofertues serioz, të formalizuar dhe zbatues korrekt të kërkesave ligjore për trajtimin e karburanteve në sasi dhe cilësi për pikat e stacioneve të përcaktuara në DT.

Lista e stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë, sipas adresave të kerkuara nga Autoriteti Kontraktor janë kërkuar pranë zonave në të cilën KESH sh.a, ushtron aktivitetin e saj si : KESH sh.a, dhe Njësitë e Prodhimit HEC Fierzë, HEC Vau Dejës, HEC Koman.

Leje mjedisore përkatëse lëshuar nga QKL, është kërkuar në mënyrë që OE të ketë aftësinë teknike për qëllim parandalimin, pakësimin dhe mbajtjen nën kontroll të ndotjes së shkaktuar nga disa kategori veprimtarish, në mënyrë që të arrihet një nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit në tërësi dhe shëndetit. Vërtetim teknik lëshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK), është kërkuar në përputhje me procedurat e lëshimit të Vërtetimit Teknik për subjektet që kryejnë aktivitet në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës dhe nën produkteve të saj nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK). Certifikatë e mbrotjes nga zjarri nga M.Z.SH është e rëndësishëm pasi tregon që operatori ekonomik ofertues ka marrë masa dhe vepron në përputhje me legjislacionin Shqiptar.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës merr përsipër furnizimin me karburant për mjetet e Autoritetit Kontraktor pranë stacioneve të tregtimit me pakicë me shërbim 24 (njëzet e katër) orë, nëpërmjet kartave elektronike të personalizuar me targën e automjetit, si dhe furnizimin me pistoletë publike.

Operatori ekonomik duhet të deklarojë gjithashtu se kartat elektronike do të jenë pa afat skadence deri në përfundimin e kontratës, si dhe se do të marrë përsipër konvertimin e sasive të litrave të mbetura në kartat elektronike në furnizim me bot, sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor deri në përfundimin e plotë të kontratës.

Operatori ekonomik duhet të sigurojë mbulimin e furnizimit me karburant nëpërmjet kartave elektronike të personalizuar sipas adresave dhe pikave të furnizimit të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Në zbatim të VKM Nr.561, datë 29.07.2016 "Për standardizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", operatori ekonomik ofertues duhet gjithashtu të disponojë dhe të ofrojë një sistem elektronik për menaxhimin e furnizimit me karburant (platformë elektronike/webpage), i cili mundëson furnizimin, monitorimin dhe administrimin e konsumit të karburantit për mjetet e Autoritetit Kontraktor.

Ky sistem duhet të mundësojë minimalisht:

- Furnizimin e mjeteve nëpërmjet kartave elektronike të personalizuar;
- Ngarkimin dhe administrimin e sasisë së karburantit nga operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor;
- Monitorimin dhe raportimin e konsumit të karburantit për çdo automjet;
- Administrimin e kartave elektronike nga Autoriteti Kontraktor;

- Krijimin e një strukture menaxhimi sipas strukturës organizative të Autoritetit Kontraktor;
- Furnizimin e mjeteve nëpërmjet kartave elektronike në formën e sticker-ave, të vendosura në xhamin e automjetit, të cilat mundësojnë furnizimin vetëm për automjetin përkatës.

Mosplotësimi i këtij kriteri përbën kusht për skualifikim.

Argumentim:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe pikës 8 të nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë disponueshmërinë e tyre për furnizimin me karburant në vendet e përcaktuara nga AK sipas kërkesave të tij në funksion të mbarëvajtjes së proceseve të punës.

Bazuar në VKM Nr 561 datë 29.07.2016 Për Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshëm, shërbimi për furnizim me karburant për mjetet efektive të transportit kryhet vetëm nëpërmjet kartës elektronike në të cilën mundësohet identifikimi i mjetit dhe përdoruesi i saj.

Faqja e menaxhimit të karburanteve (webpage) është kërkuar në mënyrë që të ofrojë shërbimin e ngarkimit të sasisë së karburantit nga OE drejt Autoritetit Kontraktor, me qëllim që rimbushja e kartave elektronike të personalizuar me targën e mjetit, si dhe administrimi i sasisë së karburanteve të kryhet nga vet AK, si dhe mundësinë e afishimit si dhe administrimin e sasise së karburanteve të kryhet nga vet Autoriteti Kontraktor. Faqja e menaxhimit të karburanteve duhet të ofrojë edhe shërbimin për krijimin e strukturës piramidale në përputhje me strukturën piramidale të Autoritetit Kontraktor, shërbimin e furnizimit me karburant nëpërmjet kartave elektronike në formën e stikerave (pullave), të cilat ngjiten në xhamin e automjetit dhe ofrojnë shërbimin e furnizimit me karburant për automjetet.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.**

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike janë hartuar referuar nevojës për furnizimin e sistemit elektronik të menaxhimit të karburantit i cili përdoret për furnizimin e mjeteve teknologjike dhe automjeteve të Njësive të Prodhimit dhe Aparatit qendror në pronësi të Korporatës Elektroenergjitike Sh.a, në zbatim të VKM Nr.561 datë 29.07.2016 “Për Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, si dhe në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” ky udhëzim përcakton detyrimin për regjistrimin, evidentimin dhe monitorimin e aktiveve publike, përfshirë automjetet dhe shpenzimet që lidhen me to, si dhe kërkon dokumentim dhe gjurmueshmëri të plotë të përdorimit të tyre.

Aktualisht, Korporata Elektroenergjitike Sh.a disponon 70 mjete të cilat e kanë të domosdoshme furnizimin me karburant pasi këto mjete përdoren për kryerjen e disa llojshmëri punësh si transport punonjësish të ndarë sipas detyrave funksionale dhe administrative, lëvizja e stafit, transport mallrash, materialesh dhe dokumentacioni, transport personeli, personel operativ, pastrime në bjefet e digës, kontroll brigjesh përgjatë shtrirjes së baseneve të Heceve etj.

Duke marrë parasysh kërkesat e ardhura nga Njësitë e Prodhimit si dhe Aparati Qendror për sasinë e nevojshme për furnizim kërkohet një sasi prej 158,364 litër karburant e llojit naftë. Kjo sasi e kërkuar llogaritet për një periudhë kohore 1 (vjeçare) për realizimin e aktivitetit të punës sipas nevojave të lartpërmendura.

Njësia e prokurimit